

20221532066

Në bazë të nenit 25, paragrafi (1) dhe (3) dhe (47), paragrafi (1), pika 20) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

**VENDIM PËR LËSHIM NË QARKULLIM TË KARTËMONEDHAVE ME VLERË
NOMINALE 100 DENARË**

1. Me këtë vendim lëshohen në qarkullim kartëmonedhat me vlerë nominale 100 denarë me shenjë të shtypjes "maj 2022" (maj 2022) dhe me karakteristikat e parapara në Vendimin për emetim, vlerën nominale dhe karakteristikave themelore të kartëmonedhave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 45/96), Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 100 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/00), Vendimi për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale prej 10, 50 dhe 100 denarë me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 4/01), Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 500 denarë me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 50/19) dhe Vendimi për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 100 denarë me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 49/21 dhe 83/22), duke filluar nga 1 gushti i vitit 2022.

2. Me lëshimin në qarkullim të kartëmonedhave nga pika 1) e këtij vendimi, në operacionet me para të gatshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut në qarkullim do të mbeten kartëmonedhat me vlerë nominale 100 denarë, të emetuara në bazë të Vendimit për emetim, vlerën nominale dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 45/96), Vendimit për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 100 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/00), Vendimit për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale prej 10, 50 dhe 100 denarë me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 4/01) dhe Vendimi për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale prej 100, 500 dhe 1000 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 139/08).

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V nr.02-15/X-5/2022
30 qershor 2022
Shkup

Guvernatore
dhe kryesuese
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
dr. **Anita Angellovska-Bezhoska**, d.v.